



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË
MËSUESVE TË LËNDËS “MUZIKË”**

SHKURT, 2024

Koordinatorë

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	3
II. QËLLIMI I PROGRAMIT	3
III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit.....	5
3.1.1 <i>Fushat kryesore të zhvillimit profesional</i>	5
3.1.2 <i>Model testi për nivelin arsimor AMU</i>	11
3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit.....	19
3.2.1 <i>Model ore mësimore për nivelin AMU</i>	19
3.2.2 <i>Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur</i>	19

I. HYRJE

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësuesi, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit punojnë me përgjegjshmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, zhvillojnë dhe përditësojnë njohuritë nëpërmjet vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve të vazhdueshme, ndërtojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së muzikës është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së muzikës në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit, si dhe për përgatitjen e orës së hapur mësimore për marrjen e kategorisë së parë të kualifikimit,
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen.

II. SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT

Synimet e hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi janë:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së muzikës në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar dhe të unifikuar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie - nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në dy pjesë:

3.1 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë (Mësues specialist) dhe të tretë (Mësues i kualifikuar) të kualifikimit. Në këtë rubrikë përfshihet, përveç kompetencave profesionale dhe rezultateve të pritshme sipas fushave kryesore të*

zhvillimit profesional, edhe një model testi për lëndën e muzikës në nivelin arsimor: *arsim i mesëm i ulët (AMU)*.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë (Mësues mjeshtër) të kualifikimit. Në këtë rubrikë ka një model ore mësimore për lëndën e muzikës në nivelin arsimor: *AMU* si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit

Programi për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit përmban fushat kryesore të zhvillimit profesional, si dhe model testi për AMU dhe AML.

3.1.1 Fushat kryesore të zhvillimit profesional

Ky program është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë janë:

- dokumentacioni zyrtar¹ shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë;
- programe lëndore të muzikës;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të lëndës së muzikës;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të muzikës.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR”

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies-nxënies; • zbaton etikën profesionale të mësuesit; • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 • Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (27.07 2022). • Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021 • Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. • Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. • Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. • Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË MUZIKËS”

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të muzikës në shkollë”	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, tematikash, në përputhje me njohuritë dhe shkathhtësitë e programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të muzikës); • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e muzikës me shkencat e tjera dhe me jetën reale. 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza Kurrikulare, 2014. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX.

**FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut
NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”**

<p align="center">Kompetenca I</p> <p align="center">“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e muzikës”</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevojë të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevojë të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj arteve dhe lëndës së muzikës; • edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës së muzikës; • motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.
<p align="center">Kompetenca II</p> <p align="center">“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e muzikës”</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA (sot ASCAP)

<ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar; • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • përdor proceset muzikore në mësimdhënien – nxënien e muzikës; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një detyre përmbledhëse. 	<p>2016.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018. • Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP 2020 Lënda: muzikë. • Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP 2021, Lënda: muzikë.
<p>Kompetenca III</p> <p>“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në muzikë”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton materiale muzikore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Finale; • nxit nxënësit të bëjnë prezantime në muzikë duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së muzikës apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime 	<ul style="list-style-type: none"> • Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së muzikës që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie. • Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. • Material ndihmës për mësuesit lidhur

materialesh nga website.	me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021.
--------------------------	---

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i muzikës:</i> <ul style="list-style-type: none"> njuh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i muzikës:</i> <ul style="list-style-type: none"> njuh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Respektimi i rigorozitetit shkencor në	

mësimdhënien e lëndës së muzikës”	
<p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e muzikës në klasat VI-IX; • përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve muzikore në klasat VI-IX; • përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehive; • dallon ndërvarësinë e koncepteve muzikore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera; • zhvillon me kreativitet mënyra të ndryshme të zhvillimit të veprimtarive artistike të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve VI-IX; • mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të muzikës me artet e tjera dhe me shkencat e tjera dhe në jetën e përditshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Programe dhe tekste të lëndës së muzikës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët.

3.1.2 Model testi për nivelin arsimor AMU

DOKUMENTACIONI SHKOLLOR

1. Bazuar në “Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, një nxënës që ndjek klasën e tetë të arsimit të mesëm të ulët, ka munguar 35% të orëve vjetore lëndore.
Në një rast të tillë, nxënësi: **1 pikë**
 - A) nuk klasifikohet në atë lëndë.
 - B) mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor.
 - C) vlerësohet me shkrim nga mësuesi i lëndës për njohuritë dhe konceptet, në të cilat ka munguar.
 - D) vlerësohet me shkrim nga një komision që ngre drejtoria e institucionit arsimor.

2. Përcaktoni cili nga standardet e mëposhtme bën pjesë në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar: **1 pikë**

- A) Idealet dhe praktikat e qytetarisë.
- B) Bashkëpunimi me kolegët dhe komunikimi.
- C) Zhvillimi i njohurive dhe i aftësive të nxënësve rreth teksteve letrare dhe joletrare.
- D) Gjuha artistike dhe arti pamor.

3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G): **2 pikë**

- a) Mirëqenia e nxënësve është një nga parimet në të cilat mbështetet vlerësimi i nxënësve në kushtet e zhvillimit të mësimin online (skenari 3), referuar udhëzuesit për fillimin e vitit shkollor 2020-2021.
V/G _____
- b) Testimi i nxënësve është një nga parimet në të cilat mbështetet vlerësimi i nxënësve në kushtet e zhvillimit të mësimin online (skenari 3), referuar udhëzuesit për fillimin e vitit shkollor 2020-2021.
V/G _____

PROGRAMI LËNDOR

Rrethoni përgjigjen e saktë

4. Programi mësimor “*Muzika*” zhvillohet përmes: **1 pikë**
- A) Linjave
 - B) Tematikave
 - C) Kapitujve
 - D) Temave mësimore

5. Tri kompetencat lëndore që duhet të zhvillojë nxënësi nëpërmjet lëndës së muzikës janë: **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

6. Zhvillimi i kompetencave kyçe të nxënësi bëhet brenda një shkalle. Formuloni dy rezultate të nxënësi për dy prej kompetencave kyçe: **2 pikë**

- a) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit _____

- b) Kompetenca dixhitale _____

ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

Rrethoni përgjigjen e saktë.

7. Baza e një planifikimi të suksesshëm është: **1 pikë**
- A) njohja dhe zbatimi me përpikmëri i të gjitha kërkesave të programit mësimor;
 - B) hartimi i rezultateve të të nxënit që janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit;
 - C) përzgjedhja e metodave dhe strategjive më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit;
 - D) të trija sa më sipër.
8. Për të realizuar temën “Koha 5/8” në tematikën “Gjuha dhe komunikimi muzikor”, momenti më i rëndësishëm është: **1 pikë**
- A) Krijimi i një situatë të nxëni përmes dëgjimit konkret të ritmit 5/8
 - B) Shkrimi i skemave të kohës 5/8 dhe shpjegimi i tyre
 - C) Shpjegimi direkt i kohës 5/8
 - D) Vetëm dëgjimi i melodive në këtë kohë
9. Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e muzikës duhet të mbajë parasysh disa parime. Renditni të paktën tre (3) prej tyre. **3 pikë**
- a) _____
 - b) _____
 - c) _____
10. Duke u mbështetur në dokumentin “Nivelet e arritjes” bëni komentimin e vlerësimit të notës 9 për tematikën “Teknika dhe procese”. **2 pikë**
- Përshkrimi i vlerësimit, nota 9:
- _____
- _____
- _____
- _____
11. Renditni tri punime që duhet të përmbajë portofoli i të nxënit në lëndën e muzikës: **3 pikë**
1. _____

2. _____
3. _____

12. Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër dhe përmban: 3 pikë

1. _____
2. _____
3. _____

ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

13. Mësuesi/ja ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi/ja, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën? 1 pikë

- a. Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- b. Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- c. Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.
- d. Mësuesja e inkurajon dhe i kërkon Jonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.

14. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për parimet themelore mbi të cilat hartohet Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar: 2 pikë

- a) Parimi i përkushtimit të prindërve ndaj nxënësit, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi në lidhje me procesin e të nxënit. V/G _____
- b) Parimi i përkushtimit ndaj komunitetit për krijimin e një mjedisi më motivues për arsimin. V/G _____

ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? 1 pikë

- A) klasat 9-ta të shkollës
- B) klasat e 9 të shkollës
- C) klasat e 9-ta të shkollës
- D) klasat e 9-të të shkollës

16. Përcakto nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme. 3 pikë

- a) elementet kimikë _____
- b) kollonë makinash _____
- c) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar _____

PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Rrethoni përgjigjen

17. Cilët janë instrumentet që shikoni në figurë, duke filluar nga e majta në të djathtë.

- A) Fagoti, klarineta, saksofoni, oboe, flauti
- B) Oboe, klarineta, saksofoni, flauti, fagoti
- C) Fagoti, oboe, saksofoni, klarineta, flauti
- D) Flauti, klarineta, saksofoni, oboe, fagoti



18. *Këngët gregoriane* këndoheshin nga një grup burrash dhe kishin karakter: **1 pikë**

- A) Kishtar
- B) Popullor
- C) Fëminor
- D) Asnjëra nga të trija

19. Shkallët me *bemola* i gjejmë duke:

1 pikë

- A) u ulur 2 nota nga nota bazë
- B) u ulur 3 nota nga nota bazë
- C) zbritur 5 tinguj nga nota bazë
- D) zbritur 4 ton nga nota bazë

20. Partitura është një nga pjesët më të njohura që i përket njërës prej simfonive të L.V.Bethovenit: **1 pikë**

- A) Sinfonia parë
- B) Sinfonia tretë
- C) Sinfonia pestë
- D) Sinfonia nëntë



21. Një nga kompozitorët e mëposhtëm **NUK** ishte pjesëtar i “Grupit të të pestëve:

1 pikë

- A) Mily Balakirev

- B) L.V.Bethoven
- C) Mikhail Glinka
- D) Nikolai Rimski Korsakov

22. Vija melodike e mëposhtme i përket tonalitetit:

1 pikë



- A) Do maxhor
- B) Sol maxhor
- C) sol minor
- D) mi minor

23. Vija melodike e mëposhtme i përket tonalitetit:

1 pikë



- A) re minor
- B) Re maxhor
- C) sol minor
- D) mi minor

24. Vija melodike e mëposhtme i përket tonalitetit:

1 pikë



- A) sol minor
- B) re maxhor
- C) Sol maxhor
- B) Si b maxhor

25. Vëzhgoni vijën melodike dhe gjeni çfarë forme muzikore është.

1 pikë











- A) Monodike
- B) polifonike
- C) homofonike

26. Gjatë shpjegimit të një periudhe muzikore, duhet marrë në shqyrtim:

1 pikë

- A) Vetëm aspekti muzikor
- B) Vetëm aspekti muzikor dhe social - kulturor
- C) Aspekti muzikor, gjeografik, historik, social e kulturor
- D) Aspekti muzikor, komercial dhe kulturor

27. Qarkoni në mënyrë korrekte atë *shenjë muzikore* që përkon me emërtimin e dhënë në krah.
3 pikë

#		Pushimi 2/4
<i>p</i>		Stakato
#	b	Diezi
		Çelësi i solit
		Lidhja shprehëse
		Simboli i ritmit

28. Duke parë vijën melodike të mëposhtme, gjeni *Tonalitetin dhe formën e shkallës* kujt i përket. 2 pikë



29. Duke parë vijën melodike të mëposhtme, gjeni *Tonalitetin dhe formën e shkallës* kujt i përket. 2 pikë



30. Ndërtoni akordet maxhore të shkallëve *Re +, La b +, Mi b +, Fa # +*.

3 pikë

31. Plotësoni vendet bosh:

2 pikë

Opera fillon me një pjesë orkestrale e cila quhet _____ e cila mbështet në materialin muzikor të _____.

32. Kur duhet të ndërtojmë një grup koral në AF ose në atë të AMU çfarë duhet të mbajmë parasysh në krijimin e korit? **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

33. Shikoni *vijën melodike* të mëposhtme dhe rishkruajeni atë në çelësin e basit. **4 pikë**



34. Përcaktoni *tre gjini të muzikës instrumentale* dhe *tre të muzikës vokale*. **3 pikë**

Gjini muzikore instrumentale	Gjini muzikore vokale

35. Ndërtoni *Intervalet muzikore 5 p, 3 + , 4 p* nga notat Do; Mi ; Fa ; La ; **4 pikë**

36. Flitni shkurt rreth periudhës së Romantizmit, duke përcaktuar: **4 pikë**

- 1) Periudhën kur u zhvillua Romantizmi?
- 2) Fushat e artit që u zhvilluan gjatë kësaj periudhe?
- 3) Përfaqësuesit më të njohur të kësaj periudhe.
- 4) Gjinitë muzikore që u zhvillua gjatë kësaj periudhe?

3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përsa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenyruar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AMU-në si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

3.2.1 Model ore mësimore për nivelin AMU

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për nivelin arsimor: AMU. *Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.*

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: IV	Klasa: 9-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor	Situata e të nxënësve:		
Tema mësimore: Shkalla muzikore <i>Re Maxhor</i> dhe <i>si minor</i>	Nxiten nxënësit të këndojnë një melodi (të parazgjedhur nga mësuesi në tonalitetin Do + në ngjitje dhe zbritje duke diskutuar karakteristikat e melodisë/këngës.		
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore: - demonstroi kuptimin e shkallës muzikore Re + dhe Si -; - ndërton shkallën Re + dhe Si - në ngjitje dhe në zbritje;	Fjalët kyçe: - shkallë muzikore - shkalla Re maxhore - shkalla si minore		

<ul style="list-style-type: none"> - shpjegon qartë njohuritë veta, mbi shkallët muzikore; - këndon saktë nga ana intonacionit shkallën Re + dhe Si - në ngjitje dhe zbritje; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teksti i nxënësit/es - Materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - Fletore pune. - Shkalla Re + dhe si - në ngjitje dhe zbritje në Cd. 	<p>Lidhja me fushat e tjera: Gjuha dhe komunikimi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>Hapi I: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5minuta) teknika brainstorming</p>	
<p>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet Nxitjes së nxënësve për këndimin e shkallës Do+ në ngjitje dhe zbritje duke kujtuar karakteristikat e saj. https://www.youtube.com/watch?v=mAmtkMUkR1s&t=8s</p>	
<p>Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta) harta e të pyeturit</p>	
<p>https://www.youtube.com/watch?v=lfBWxenfU2s</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Vendoset në cd të dëgjohet shkalla Remaxhore në ngjitje dhe zbritje, - shkruhet në dërrasë dhe këndohet së bashku me nxënësit <i>Re,do#,si,la,sol,fa #,mi,re.</i> - shpjegohen pse vendosen shenjat e shartimit, - më pas punohet për shpjegimin e shkallës relative Si minore. - këndohen disa herë shkallët në ngjitje dhe zbritje vetëm dhe në grup të shkallës disa herë. 	
<p>Hapi III:Reflektimi (10 minuta) Teknika Kllaster Përsëritjen të gjitha njohuritë e marra mbi shkallët me dy shenja shartimi duke zhvilluar teknikën e pyetje dhe përgjigje. Më pas këndohen shkallët në ngjitje dhe zbritje</p>	
<p>Vlerësimi Nxënësi demonstroi aftësitë në: N 2 - kuptimin e shkallës muzikore Re + dhe Si -; N 3 - ndërtimin e shkallëve Re + dhe Si -; N 4 - këndimin korrekt të të shkallëve Re + dhe Si - në intonacion në ngjitje dhe në zbritje. N 4 - bashkëpunimin dhe këndimin në grup me të tjerët.</p>	
<p>Dozja me punime personale - Ndërtimi një ushtrimi në kohën 2/4 në shkallët që sapo mësove.</p>	

3.2.2 Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore;

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur				
Gjithsej 70 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)				
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësve	0 – 1 pikë Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënësve (RN) nuk bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënësve. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.	2 – 3 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësve, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënësve (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënësve, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.	4 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësve, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe teknikat mësimore janë në një koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënësve dhe me stilet e të nxënësve. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	5 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësve të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënësve, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.
Mësuesi ka planifikuar për	0 – 1 pikë Mësuesi ka një	2 – 3 pikë Mësuesi në	4 pikë Mësuesi në	5 pikë Mësuesi në

<p>temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore</p>	<p><i>planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>
--	---	---	--	--

Mjedisi i të nxënësve (14 pikë)

<p>Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.</p>	<p><i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimet vetëm disa nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i></p>
<p>Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me</p>	<p><i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimet në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxitin të marrin pjesë në</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimet në mënyrë tradicionale, ku jo të gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimet duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimet duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të</i></p>

vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>ndërmarrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
Metodat mësimore (21 pikë)				
Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stileve të nxënimit	<i>0 – 1 pikë Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së zgjedhur dhe demonstroi që nuk i njeh stilet e të nxënimit. Ora e mësimi është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënimit të nxënësve të tij por ora e mësimi është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të nxënimit.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënimit të nxënësve të tij por metodat e teknikat që përdor në orën e mësimi nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënimit duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që njeh shumë mirë stilet e të nxënimit të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënimit duke i dhënë mundësi nxënësit të përmirësojnë arritjet e tij.</i>
Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin).	<i>0 – 1 pikë Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimi fokusohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshërinë e metodave të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve	<i>0 – 1 pikë Mësuesi</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi</i>

dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>demonstron që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>demonstron që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>demonstron që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe njëri – tjetrit.</i>
---	--	---	--	---

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)

Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij.	0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit.</i>	4 - 5 pikë <i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i>	6 - 7 pikë <i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>
Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes.	0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstron se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstron se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>

Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënimit dhe nevojave të nxënësve	0 – 1 pikë <i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënimit apo nevojat e nxënësve.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënimit dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënimit të temës mësimore.</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	4 pikë <i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore,</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënimit të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK.</i>	4 pikë <i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

